LIGJ
Nr.9659, datë 18.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), QË LIDHET ME MARRËVESHJEN E KREDISË NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË KUADËR TË PROGRAMIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË TË EUROPËS JUGLINDORE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), që lidhet me marrëveshjen e kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në kuadër të programit të Komunitetit të Energjisë të Europës Juglindore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5172, datë 28.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE GARANCIE
(PROJEKTI I REHABILITIMIT TË NËNSTACIONEVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Marrëveshje e datës 2006 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka)

HYRJE

Meqenëse Garantuesi dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare kanë kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

meqenëse në bazë të marrëveshjes së huasë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare si Huamarrës dhe Bankës (Marrëveshja e huasë sipas parashikimit të termave dhe kushteve standarde), Banka ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua në shumën 16 000 000 euro, në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara në marrëveshjen e huasë, me kusht që Garantuesi të garantojë përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huasë, në përputhje dhe me këtë Marrëveshje;

meqenëse Garantuesi, duke vlerësuar lidhjen e marrëveshjes së huasë nga Banka me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë përmbushjen e detyrimeve të tilla për Huamarrësin,

për sa më sipër, Palët më poshtë bien dakord si vijon:

Neni 1
Termat dhe kushtet standarde, përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës së datës 1 maj 2006 janë përfshirë në këtë Marrëveshje, si dhe janë bërë të zbatueshme me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur janë pasqyruar plotësisht këtu (këto dispozita do të quhen më tej "Termat dhe kushtet standarde").

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që të haset në këtë Marrëveshje (duke përfshirë si hyrjen, ashtu edhe Listeet), vetëm nëse është thënë me kuptim tjetër, apo ka kuptim tjetër në kontekst, termat e përcaktuar në hyrje kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, ndërsa termat shtesë të mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Përfaqësuesi i autorizuar i Garantuesit" do të thotë Ministri i Financave i Garantuesit.

"Programi i asistencës menaxheriale" do të thotë programi i asistencës për menaxherët kryesorë të Huamarrësit dhe OST-së e ngritur prej Huamarrësit sipas termave dhe kushteve të kënaqshme për Bankën.

"Strategjia Kombëtare e Energjisë" do të thotë strategjia e miratuar nga Qeveria e Shqipërisë në qershor 2003, e cila identifikon investimet prioritare, nevojat për financime, si dhe reformat e kërkuara në sektorin energjetik, siç mund të amendohen herë pas here.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje referenca për një nen ose seksion të caktuar, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të konsiderohet si referencë për këtë nen ose seksion të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Garancia, detyrime të tjera

Seksioni 2.01 Garancia

Garantuesi këtu garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruari kryesor dhe jo thjesht si garant, pagimin e përpiktë të çdo dhe të gjitha shumave sipas marrëveshjes së huasë, qoftë në momentin e maturimit, me parapagim ose ndryshe, si edhe përmbushjen e përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, ashtu siç janë parashtruar në marrëveshjen e huasë.

Seksioni 2.02 Përfundimi i projektit

a) Kurdo që të ketë një shkak të arsyeshëm për të besuar se fondet e vëna në dispozicion Huamarrësit do të jenë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e llogaritura për kryerjen e projektit, Garantuesi do të marrë në mënyrë të menjëhershme masa të kënaqshme për Bankën për t'i siguruar Huamarrësit, ose do të bëjë që t'i sigurohen Huamarrësit fondet që janë të nevojshme për të përballuar këto shpenzime ose detyrime.

b) Pa kufizuar përgjithësinë e cilësdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje apo të termave dhe kushteve standarde, Garantuesi do të autorizojë Huamarrësin të vërë në jetë, aq herë sa do të jetë e nevojshme, rregullime në nivelin dhe strukturën e tarifave të Huamarrësit, me qëllim sigurimin se Huamarrësi është në gjendje të përmbushë detyrimet e veta në përputhje me seksionet 3.01(c) dhe 3.01(d) të marrëveshjes së huasë.

Seksioni 2.03 Detyrime të tjera

Garantuesi:

a) do të shmangë vënien e çdo takse direkte ose indirekte ndaj konsulentëve të huaj të punësuar nga Banka ose Huamarrësi në zbatim të projektit dhe të financuar nga të ardhurat e huasë ose nga çdo fond tjetër i bashkëpunimit teknik i vënë në dispozicion nga Banka;

b) do të zbatojë masat e rekomanduara nga strategjia kombëtare e energjisë;

c) do të zbatojë masat që do të merren nga Qeveria e Shqipërisë të rekomanduara nga plani i veprimit dhe do të mbështesë zbatimin e planit të veprimit prej Huamarrësit;

d) do të shmangë ndërhyrjen në praktikat standarde të arkëtimit të Huamarrësit;

e) do t'i paguajë Huamarrësit shumat e prapambetura të institucioneve buxhetore dhe

ndërmarrjeve shtetërore siç është rënë dakord në planin e veprimit, pagesa e fundit e të cilave në datën 31 dhjetor 2007 do të bëjë bilancin e detyrimeve të prapambetura zero;

f) me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, do të mbështesë zbatimin e programit të asistencës menaxheriale në një mënyrë të kënaqshme për Bankën;

g) do t'i japë Huamarrësit të drejtën e eliminimit të arkëtimeve të pambledhura nga faturat e energjisë elektrike, në një mënyrë që përputhet me praktikat standarde industriale dhe në përputhje me planin e veprimit;

h) do të sigurojë ose bëjë që të sigurohen, kur të kërkohet, të gjitha licencat shtetërore, miratimet apo rënien dakord të kërkuar prej Huamarrësit për financimin dhe vazhdimin e projektit, si dhe vazhdimin e biznesit, duke përfshirë të gjitha miratimet dhe licencat e nevojshme që i garantojnë Huamarrësit dhënien e lejeve të ndërtimit dhe shfrytëzimit apo pronësisë së tokës të nevojshme për kryerjen e projektit;

i) do të shmangë kërkesat ndaj Huamarrësit për të bërë investime të reja ose për të hyrë në ndonjë marrëveshje koncesionare që nuk janë pjesë dhe nuk janë përfshirë në planin e biznesit të Huamarrësit, dhe në veçanti do të shmangë kërkesat ndaj Huamarrësit për të bërë koncesione të reja në lidhje me hidrocentralet e vegjël;

j) do të mbështesë çdo përpjekje të Huamarrësit për të eliminuar tarifat e subvencionuara të energjisë elektrike për konsumatorët buxhetorë dhe jobuxhetore, si dhe për konsumatorët privatë, të përcaktuar në planin e veprimit;

k) do të mbështesë zbatimin prej Huamarrësit të fondit balancues;

l) do të zbatojë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet e Garantuesit në përputhje me traktatin ECSEE, të datës 25 tetor 2005;

m) do të zhvillojë dhe miratojë, përpara datës 31 dhjetor 2006, procedura transparente dhe konkurruese për dhënien e koncesioneve të reja në lidhje me hidrocentralet e vegjël;

n) do të shmangë ndërhyrjen ndaj planit të investimeve të Huamarrësit;

o) do të sigurojë një operator plotësisht funksional të sistemit të transmetimit (OST) nga data 1 korrik 2007;

p) do të mbështesë çdo përpjekje të Huamarrësit për të vënë në jetë, sa herë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, rregullime në nivelin dhe strukturën e tarifat e Huamarrësit për të siguruar që Huamarrësi është në gjendje për të përmbushur detyrimet e veta që rrjedhin nga targetet e planit të veprimit, si dhe për të arritur arkëtimin e kostos së plotë;

q) do të krijojë dhe do të zbatojë një mekanizëm ose procedura për të zvogëluar pasojat e çdo rritjeje në nivelin e tarifave të energjisë elektrike te konsumatorët socialë me vulnerabël;

r) nuk do të amendojë, pezullojë, shfuqizojë, anulojë apo rregullojë kuadrin legjislativ dhe rregullues të zbatueshëm për sektorin energjetik në territorin e Garantuesit, me përjashtim të rasteve kur këto veprime, sipas gjykimit të vetë Bankës janë në përputhje me ato të targetuara në planin e veprimit ose deklaratën e politikave të sektorit energjetik.

Neni 3

Të ndryshme

Seksioni 3.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme parashikohen në funksion të sektorit 10.01 të termave dhe kushteve standarde.

Për Garantuesin:	**Për Bankën:**
Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr.1. Tiranë, Shqipëri Në vëmendje të: Ministri i Financave Fax: +355 4 22 8494	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim One Exchange Square, London EC2A 2JN, UK To the attention of: Operational Administration Unit Fax: +44 20 7338 6100

Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

Në funksion të seksionit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde dhe në përputhje me seksionin 6.02 të marrëveshjes së huasë, opinioni apo opinionet ligjore në emër të Garantuesit do të jepen nga Ministri i Drejtësisë.

Në dëshmi të sa më sipër, Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në katër kopje, në Tiranë, Shqipëri, në ditën dhe vitin e përcaktuar më lart.

MARRËVESHJE E HUASË

PROJEKTI I REHABILITIMIT TË NËNSTACIONEVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Marrëveshje e datës 2005 ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (Huamarrësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka)

HYRJE

Duke pasur parasysh se Banka është krijuar për financimin e projekteve specifike për tranzicionin e ekonomive të orientuara drejt tregut të hapur, si dhe për të nxitur iniciativat private dhe sipërmarrjet në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të angazhuara dhe që zbatojnë parimet e demokracisë, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

se Huamarrësi synon të zbatojë projektin e përshkruar në listën 1 ("Projekti") që është disenjuar për të ndihmuar Huamarrësin në financimin e zëvendësimit të pajisjeve të vjetruara të tensionit të lartë, si dhe në kontrollin e sistemeve të mbrojtjes në gjashtë nënstacione në Republikën e Shqipërisë;

se Huamarrësi synon të alokojë një shumë të përafërt me katër milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë euro (4 112 000 euro) për financimin e projektit;

se Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

se Republika e Shqipërisë ka marrë një hua (shuma e së cilës i është vënë në dispozicion tashmë Huamarrësit) nga Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar, në shumën e njëzet e shtatë milionë dollarë (27 000 000 USD) për të asistuar në financimin e një pjese të projektit, sipas termave dhe kushteve të parashtruara në një marrëveshje (Marrëveshja e bashkëfinancimit), ku kanë hyrë Huamarrësi dhe Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar;

se Huamarrësi synon të alokojë një shumë të përafërt me katër milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë euro për financimin e projektit;

se, në mbështetje të një marrëveshjeje garancie të datës së përcaktuar këtu ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Garantuesi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Marrëveshja e garancisë), Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

se, sikurse është rënë dakord më parë, Banka, ndër të tjerash, do të mundësojë huanë për Huamarrësin për një shumë prej 16 milionë euro (gjashtëmbëdhjetë milionë euro), subjekt i termave dhe kushteve të paraqitura apo referuar kësaj Marrëveshjeje; dhe

atëherë, pjesëmarrësit këtu bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termat dhe kushtet standarde, përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës së datës 1 maj 2006, janë përfshirë në këtë Marrëveshje, si dhe janë bërë të zbatueshme me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur janë pasqyruar plotësisht këtu (këto dispozita do të quhen më tej "Termat dhe kushtet standarde").

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që të haset në këtë Marrëveshje (duke përfshirë si hyrjen, ashtu dhe Listeet), vetëm nëse është thënë me kuptim tjetër, apo ka kuptim tjetër në kontekst, termat e përcaktuara në hyrje kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimin përkatës që iu është dhënë aty, ndërsa termat shtesë të mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Plani i veprimit" do të thotë plani i përgatitur nga KESH dhe i miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.43, të datës 13 janar 2006 "Mbi miratimin e planit të veprimit në lidhje me performancën e sektorit të energjisë për periudhën 2006-2008", bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje si shtojca A, ripunimet e përvitshme bërë pas kësaj, të pranueshme për Bankën.

"Përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit" do të thotë Ministri i Financave i Huamarrësit, me përjashtim të rasteve të specifikuar në seksionin 2.03(c).

"Rrjedhja kesh e disponueshme për shërbimin e borxhit" do të thotë rrjedhja e keshit nga aktivitetet operuese plus çdo interes të paguar gjatë kësaj periudhe.

"Rrjedhja kesh nga aktivitetet operuese" do të thotë të gjitha rrjedhjet e keshit nga aktivitetet operuese siç përcaktohet nga IFRS. Nëse, për ndonjë arsye, deklarimet financiare të audituara IFRS nuk janë të disponueshme për ndonjë vit fiskal, rrjedhja kesh nga aktivitetet operuese do të thotë, për një periudhë të tillë, të ardhurat neto të Huamarrësit gjatë kësaj periudhe pas tatimit, plus amortizimin dhe nënçmimin, plus çdo shpenzim jo kesh të kryer plus çdo zbritje gjatë kësaj periudhe (ose, nëse është rasti, minus çdo rritje gjatë kësaj periudhe) në kapitalin funksional.

"Bashkëmenaxhues" do të thotë një njësi e përfshirë në zbatim të programit të asistencës menaxheriale dhe të pranueshme për Bankën.

"Borxh" do të thotë, në lidhje me Huamarrësin, mbi baza të konsoliduara, të gjitha detyrimet e Huamarrësit mbi baza të konsoliduara, të gjitha detyrimet e Huamarrësit të kryera si principale apo dytësore, si dhe të tashme, të ardhshme, faktike apo kontigjence, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te:

a) çdo shumë e pagueshme prej Huamarrësit sipas qirave apo marrëveshjeve të ngjashme përgjatë periudhave të tyre respektive;

b) çdo kredi e dhënë Huamarrësit prej një furnizuesi mallrash ose si pasojë e një blerjeje me këste apo sipas një marrëveshjeje tjetër të ngjashme; dhe

c) çdo përgjegjësi dhe detyrim ndaj palëve të treta në masën që ato janë garantuar prej Huamarrësit ose që Huamarrësi në një mënyrë ose në një tjetër ka marrë përsipër ose është bërë përgjegjës për pagesën e detyrimeve të tilla ose në masën që ato janë siguruar nga ndonjë barrë mbi pronën e Huamarrësit, pavarësisht nëse Huamarrësi e ka marrë përsipër ose është bërë përgjegjës për pagesën e detyrimeve të tilla.

"Shërbimi i borxhit" do të thotë, për çdo periudhë, shumën e të gjitha pagesave të planifikuara të principalit, interesit dhe tarifat mbi borxhin e Huamarrësit.

"Llogaria e shërbimit të borxhit" do të thotë llogaria e posaçme që përfiton interes e referuar në seksionin 3.08(a).

"Raporti i mbulimit të shërbimit të borxhit" do të thotë raporti i përfituar pas ndarjes së rrjedhjes së keshit e disponueshme për shërbimet e borxhit nga shërbimi i borxhit.

"Sasia rezervë e shërbimit të borxhit" do të thotë, në çdo kohë dhe në lidhje me monedhën e huasë, shumën e principalit, interesit dhe shumat e tjera të planifikuara për t'u bërë të disponueshme dhe të pagueshme Bankës gjatë gjashtëmujorit pasues e shumëzuar me 1.25.

"EBITDA" do të thotë fitimi operativ i Huamarrësit përpara marrjes në konsideratë të interesit, tatimit, nënçmimit dhe amortizimit, duke përjashtuar gjithashtu çdo element të jashtëzakonshëm dhe të veçantë.

"Plani i veprimit të mjedisit"-do të thotë plani i veprimit të mjedisit, bazuar në rekomandimet

mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis që duhet rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës në formë e përmbajtje i pranueshëm nga Banka, duke pasur parasysh mjedisin e lidhur me projektin, siç mund të amendohet herë pas here me miratim paraprak të shkruar nga Banka.

"Çështje mjedisore" do të thotë:

a) ndotja ose mbrojtja e mjedisit;

b) dëmi ndaj ose mbrojtja prej tij e shëndetit njerëzor;

c) shëndeti dhe siguria në vendin e punës; ose

d) çdo lëshim ose substancë e aftë të shkaktojë dëmtimin e një organizmi të gjallë ose të mjedisit.

"Traktati i Komunitetit të Energjisë të Europës Juglindore" (ECSEE) do të thotë traktati i nënshkruar në datën 25 tetor nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Republika e Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Republika e Turqisë, Serbisë dhe Malit të Zi, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Kosovës dhe Komuniteti Europian, që parashtron angazhimin dhe procesin e pjesëmarrësve për të përmirësuar sektorin e energjisë së rajonit të Europës Juglindore dhe për të krijuar një treg për energjinë dhe gazin në rajonin e Europës Juglindore, siç mund të amendohen herë pas here.

"Fondi balancues" do të thotë një fond që do të krijohet nga KESH, me qëllim që fitimet që rezultojnë nga kushtet e favorshme hidrologjike të ruhen në këtë fond për të mbuluar koston e importit të energjisë elektrike, në rastet e kushteve jo të mira hidrologjike.

"Vit fiskal" do të thotë periudha 12-mujore që nis në 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor.

"IFRS" do të thotë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të lëshuara ose miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe të zbatuara në mënyrë konsistente.

"Plani i investimeve" do të thotë një plan investimesh i përgatitur prej Huamarrësit në një formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën:

"Lek" do të thotë monedha e ligjshme në Republikën e Shqipërisë.

"Llogaria lokale e projektit" do të thotë llogaria e posaçme që përfiton interes, e referuar në seksionin 3.08 (b).

"Sasia rezervë lokale e projektit" do të thotë në çdo moment gjatë periudhës së ndërtimit, sasia e kontributit të Huamarrësit për projektin gjatë gjashtëmujorit pasues.

"Programi i asistencës menaxheriale" do të thotë programi i asistencës për menaxherët kryesorë të Huamarrësit dhe OST-së e referuar në seksionin 3.06.

"Raporti operacional" do të thotë një raport operacional, në një formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, që i dërgohet Bankës prej Huamarrësit.

"PMU" do të thotë njësia e menaxhimit të projektit e referuar në seksionin 3.02.

"Deklarata e politikave të sektorit energjetik" do të thotë deklarata e politikave e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Garantuesit më 19 prill 2002, siç mund të amendohet herë pas here me miratimin e Bankës.

"Çështje sociale" do të thotë:

a) standardet e punës dhe kushtet e punësimit të rregulluara nga ligji i zbatueshëm;

b) pasojat te njerëzit dhe prej zhvendosjes ose blerjes së tokës;

c) pasojat te njerëzit lokalë ose grupe të tjera të ndjeshme (vulnerabël);

d) pasojat mbi objektet e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë këtu edhe artifaktet dhe zonat arkeologjike;

e) ose konsultimet dhe bërjen publike të tyre, duke përfshirë këtu edhe zemëratën e një pjese të publikut të njoftuar prej Huamarrësit;

"OST" do të thotë operatori i sistemit të transmetimit, që i është referuar seksioni 3.01(f).

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referimi ndaj një neni specifik, seksioni apo liste, (me përjashtim të rasteve që nuk paraqiten në këtë Marrëveshje), do të paraqitet si referencë për atë nen apo seksion specifik apo listë në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Termat kryesorë të huasë

Seksioni 2.01 Shuma dhe monedha

Bazuar në termat dhe kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje, Banka bie dakord të japë një hua për Huamarrësin në një shumë prej gjashtëmbëdhjetë milionë (16 000 000) euro.

Seksioni 2.02 Terma të tjerë financiarë të huasë:

a) sasia minimale për tërheqje do të jetë pesëdhjetë mijë euro (50 000 euro);

b) sasia minimale e parapagesës do të jetë pesë milionë euro (5 000 000 euro);

c) sasia minimale e anuluar do të jetë tre milionë euro (3 000 000 euro);

d) data e pagesës së interesit do të jetë 4 prilli dhe 4 tetori i çdo viti;

e) (1) Huamarrësi do të paguajë huanë në 18 këste të barabarta (apo afërsisht të barabarta), në periudha gjashtëmujore më 4 prill dhe 4 tetor të çdo viti, me datë të parë të pagimit të huasë më 4 prill 2010 dhe datë të fundit të pagimit të huasë më 4 tetor 2018.

2. Pavarësisht, çfarë është paraqitur më lart, në rast se: (i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e huasë para datës së parë të ripagimit të specifikuar në seksionin 2.02(e), dhe (ii) Banka e shtyn datën e fundit të disponueshmërisë së specifikuar në seksionin 2.02(f) më poshtë në një datë e cila bie pas kësaj date ripagimi, ndaj shuma e kësaj tërheqjeje, të bërë në apo pas datës së parë të ripagimit duhet të shpërndahet për ripagim në shuma të barabarta në data të ndryshme të ripagimit të huasë, të cilat janë pas datës së kësaj tërheqjeje (ku Banka rregullon shumat e shpërndara në mënyrën më të mirë të mundshme). Banka herë pas here duhet të njoftojë Huamarrësin për këtë shpërndarje;

f) data e fundit e disponueshmërisë duhet të jetë 31 dhjetor 2009;

g) tarifa e angazhimit do të jetë 0.5% në vit;

h) huaja është subjekt i normave të ndryshueshme të interesit. Pavarësisht çfarë është paraqitur më lart, Huamarrësi mundet, që si një alternativë për pagesën e normës së ndryshueshme të interesit mbi të gjithë apo ndonjë pjesë të huasë në atë moment të papaguar, të zgjedhë të paguajë interesin me një normë fikse interesi mbi këtë pjesë të huasë në përputhje me seksionin 3.04(c) të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 2.03 Tërheqjet

a) Sasia e disponueshme mund të tërhiqet nga një periudhë në tjetrën, në përputhje me parashikimet e bëra në listën 2, për të financuar: (1) shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka bie dakord që këto të realizohen) në përputhje me kostot e arsyeshme të punimeve të kërkuara për projektin, dhe (2) komisionin përmbyllës.

Neni 3
Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01 Angazhime të tjera të miratuara

Përveç angazhimeve të përgjithshme të paraqitura në nenin 4 të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të dhënë fondet e nevojshme për përfundimin e projektit;

b) do të miratojë dhe zbatojë planin e veprimit duke mbuluar të gjitha aspektet e operacioneve të tij për periudhën dyvjeçare pasuese përpara datës 31 dhjetor të çdo viti.

c) do të sigurojë arritjen e duhur të targeteve financiare të specifikuara në planin e veprimit dhe në veçanti të sigurojë se targetet në lidhje me humbjet dhe arkëtimet arrihen për çdo tremujor kalendarik në fund të atij tremujori;

d) do të kërkojë kur është e nevojshme dhe në përputhje me procedurat në fuqi të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar, prej autoriteteve rregullatore përkatëse të Garantuesit ristrukturimin e çmimeve për konsumatorët për të arritur nivelin e kostos në shkallë korporate mbi bazën e çdo tremujori dhe në një minimum në përputhje me planin e veprimit në fuqi;

e) do të zbatojë, mbi bazën e kontratës së asistencës menaxheriale, programin e asistencën menaxheriale mbi termat e referencës dhe në një mënyrë të kënaqshme për Bankën përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit;

f) do të ndajë asetet e operatorit të ri të transmetimit të energjisë (OST) nga ato të Huamarrësit dhe të përfundojë ndarjen financiare ndërmjet Huamarrësit dhe OST-së nga fundi i vitit 2007;

g) do të zhvillojë një plan biznesi për operatorin e ri të transmetimit të energjisë OST përpara datës 31 dhjetor 2006; dhe

h) do të zbatojë dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet e traktatit të ECSEE.

Seksioni 3.02 Njësia e menaxhimit të projektit

a) Huamarrësi do të krijojë një njësi të zbatimit të projektit ("PMU") me të gjitha burimet e mjaftueshme, si dhe një personel të kualifikuar, duke përfshirë ndërmjet të tjerëve edhe një punonjës financiar dhe një punonjës prokurimi, me qëllim që të koordinohen, menaxhohen, monitorohen dhe vlerësohen të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, nën termat e referencës të pranueshme nga Banka, duke përfshirë dhe prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të projektit.

b) Huamarrësi, nën termat e referencës të pranuara nga Banka, do të mbajë dhe do të krijojë mundësinë e operimit të konsulentëve për të ndihmuar PMU-në gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit me synim:

1. rishikimin dhe finalizimin e çështjeve të prokurimit, duke përfshirë edhe dokumentet e tenderimit;

2. procesin e tenderimit;

3. raportimin në kohë dhe me saktësi;

4. monitorimin dhe rifreskimin e sasisë së rezervës së projektit lokal dhe llogarinë lokale të projektit; dhe

5. mbikëqyrjen e zbatimit të përgjithshëm të projektit.

Seksioni 3.03 Prokurimet

Për qëllime të seksionit 4.03 të termave dhe kushteve standarde, masa të tilla duhen zbatuar, me përjashtim të rasteve kur Banka nuk është dakord, të cilat do të drejtojnë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga procedurat e huasë.

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet do të prokurohen me tender të hapur në përputhje me politikat dhe rregullat e prokurimit të BERZH-it.

b) Për qëllime të seksionit 3.03(a), procedurat për tenderimin e hapur, tenderimin me përzgjedhje, tenderimin e drejtpërdrejtë, si dhe për blerjet e standardet për tenderimin mbi bazën e konkurrencës brenda vendit, janë paraqitur në kapitullin 3 të rregullave të prokurimit të BERZH-it.

c) Të gjithë kontratat do të jenë subjekt i rishikimit të procedurave të paraqitura në aneksin 1 të rregullave të prokurimit të BERZH. Kontratat për mallra, punime dhe shërbime që vlerësohen të kushtojnë me tepër se 200,000 euro ose ekuivalenten e kësaj shume në një monedhë tjetër, do të jenë subjekt i rishikimit paraprak të BERZH-it.

Seksioni 3.04 Angazhimet lidhur me mjedisin

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, si dhe seksionit 3.04(c) më lart, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi:

a) me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe në planin e veprimit të mjedisit, do të realizojë projektin në përputhje me rregullat dhe standardet e mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë që ndryshojnë hera-herës, sipas juridiksionit të vendit ku ndeshet projekti, si dhe me standardet ekzistuese të BE-së mbi mjedisin, shëndetin dhe sigurinë nëse janë të zbatueshme dhe nëse jo me standardet mjedisore në udhëzuesit e grupit të Bankës Botërore;

b) do t'i përmbahet të gjitha ligjeve të zbatueshme, si dhe standardeve mbi punësimin, në veçanti ato të lidhura me punësimin e fëmijëve dhe të të rinjve, diskriminimin në punë, si dhe punën e detyruar. Ligjet dhe standardet e aplikueshme përfshijnë: (i) angazhimet përkatëse lidhur me Organizatën Ndërkombëtare të Punës, dhe (ii) ligjin vendas; dhe

c) do të zbatojë në mënyrë të kujdesshme dhe do të përkrahë planin e veprimit të mjedisit.

Seksioni 3.05 Konsulentët

a) Me qëllim që të mbështetet zbatimi i projektit, Huamarrësi duhet që, me përjashtim të rasteve kur Banka nuk është dakord, të punësojë apo të krijojë mundësi punësimi për konsulentë, duke përfshirë, por duke u kufizuar me kaq, një konsulent monitorimi mjedisor për projektin, kualifikimi, eksperienca dhe termat e referencës së të cilëve janë të pranueshme nga Banka. Këta konsulentë do të ndihmojnë PMU-në me prokurimet, mbikëqyrjen e zbatimit, trajnimin dhe transferimin e *know-how*.

b) Huamarrësi duhet të paraqesë, pa tarifë, përpara çdo konsulenti të përfshirë në mbështetjen e elementeve të projektit apo në operacionet e Huamarrësit, të gjitha lehtësirat e nevojshme, si dhe mbështetjen e nevojshme për të realizuar funksionet e tyre, duke përfshirë këtu të gjitha dokumentet, materialet, si dhe çdo informacion tjetër që mund të lidhet me punën e tyre.

Seksioni 3.06 Programi i asistencës menaxheriale

Huamarrësi do të themelojë dhe mbajë programin e asistencën menaxheriale, me terma dhe kushte të pranueshme për Bankën, sipas të cilit Huamarrësi do të kontraktojë një shoqëri utilitetesh të huaj që do t'i sigurojë një ekip bashkëmenaxherësh për të kryer detyra të caktuara me qëllim përmirësimin e të gjitha aspekteve të operacioneve të Huamarrësit.

Seksioni 3.07 Frekuenca e raportimit dhe kërkesat për paraqitjen e dokumenteve

a) Deri në pagesën e plotë apo anulimin e shumës së huasë, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës raporte vjetore lidhur me çështjet mjedisore të projektit referuar seksionit 5.02(c)(iii) të termave dhe kushteve standarde, më apo përpara datës 31 mars të çdo viti. Raporte të tilla do të përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me shëndetin e punëtorëve, si dhe sigurinë e tyre lidhur me projektin, sikurse dhe elemente të tillë specifikë, si:

i) informacion mbi respektimin nga ana e Huamarrësit të rregullave dhe standardeve lidhur me mjedisin, specifikuar në seksionin 3.04, duke përfshirë dhe statusin e çfarëdo leje mjedisore të kërkuar për projektin, rezultatet e cilitdo inspektim të kryer nga autoritetet e mjedisit, ndonjë shkelje të rregullave dhe standardeve të tilla të mjedisit, si dhe masat përmirësuese të ndërmarra apo dhe gjoba të vëna në raste shkeljesh;

ii) informacion lidhur me zbatimin e planit të veprimit të mjedisit, duke përfshirë dhe ndonjë ndryshim të propozuar apo devijim në veprime, kalendar apo kosto;

iii) një përmbledhje të çfarëdo shënimi material, raporteve apo komunikimeve lidhur me çështjet e mjedisit apo ato sociale, të paraqitura nga Huamarrësi përpara cilitdo autoriteti rregullator;

iv) informacion lidhur me shëndetin dhe sigurinë e projektit, duke përfshirë dhe shkallën e aksidenteve apo çdo iniciativë të lidhur me shëndetin dhe çështjet e sigurisë që janë zbatuar apo planifikuar nga Huamarrësi;

v) një përmbledhje të ndryshmeve në ligjet e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, që mund të kenë një ndikim material mbi projektin;

vi) kopje të informacionit mbi çështjet mjedisore dhe ato sociale të paraqitura në mënyrë periodike nga Huamarrësi pranë partnerëve apo në publik.

b) Raportet periodike të projektit referuar seksionit 4.04(a)(iv) të termave dhe kushteve standarde duhet të paraqiten çdo tremujor, brenda 30 ditëve të periudhës së raportuar, kjo deri në përfundim të projektit. Këto raporte do të përmbajnë elementet specifike si më poshtë:

i) informacion të përgjithshëm si më poshtë:

1. progresin fizik të përmbushur në zbatim të projektit deri në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

2. vështirësitë aktuale apo të pritshme sikurse dhe vonesat në zbatim të projektit, si dhe ndikimin e tyre në kalendarin e zbatimit, si dhe hapat konkretë të marra apo të planifikuara për të kaluar vështirësitë dhe shmangur vonesat;

3. ndryshimi i mundshëm i datës së përfundimit të projektit;

4. ndryshime në personelin kryesor të PMU-së, konsulentëve apo kontraktorëve;

5. arsyet që mund të ndikojnë në koston e projektit; dhe

6. ndonjë zhvillim apo aktivitet që ka të ngjarë të ndikojë në aspektin ekonomik të cilësdo pjesë të projektit;

ii) një diagramë e tipit *bar-chart*, bazuar në kalendarin e zbatimit të projektit, duke treguar progresin në çdo pjesë të projektit, si dhe duke përfshirë një grafik të shpenzimeve të planifikuara, si dhe atyre aktuale;

iii) raportet financiare duhet të paraqesin detaje të shpenzimeve të realizuara nën secilën pjesë të projektit, si dhe tërheqjet nga huaja, së bashku me një deklaratë, ku tregohen:

1. llogaritjet origjinale të kostos;

2. kostot e rishikuara, nëse ka të tilla, si dhe arsyet për këto ndryshime;

3. llogaritjet origjinale të shpenzimeve deri në datën e raportimit;

4. arsyet për devijimet e pikës (3) më lart nga shpenzimet aktuale; dhe

5. shpenzimet e llogaritura për tremujorët e mbetur të vitit; dhe

iv) një dokument i shkurtër mbi statusin e përputhshmërisë me secilën nga angazhimet e marra në marrëveshjen e huasë.

c) Menjëherë, me ndodhjen e ndonjë incidenti apo aksidenti të lidhur me projektin që ka të ngjarë të ketë dhe një efekt jo të favorshëm material mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, Huamarrësi

duhet të njoftojë Bankën me anë të njoftimit me faks apo telex, duke specifikuar natyrën e një incidenti apo aksidenti të tillë, si dhe ndonjë hap të ndërmarrë nga Huamarrësi për rregullimin e situatës. Pa kufizuar përgjithësinë e kësaj, një incident ose një aksident ka të ngjarë që të shkaktojë një efekt material mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, nëse çdo ligj i aplikueshëm kërkon njoftimin e një incidenti apo aksidenti të tillë pranë cilitdo autoriteti shtetëror, incidente apo aksidente të tilla përfshijnë fatalitetet apo plagosje serioze që kërkojnë shtrim në spital, apo nëse një incident apo aksident i tillë është bërë publik si nëpërmjet medias, apo mjeteve të tjera.

Seksioni 3.08 Llogaritë e projektit

a) Huamarrësi, për qëllime të projektit, ka të drejtë të hapë dhe të mbajë deri në përfundimin e plotë dhe të çdo detyrimi që ai ka nën këtë Marrëveshje, një llogari të posaçme depozite në monedhën e huasë (Llogaria e shërbimit të huasë) në një bankë tregtare me terma dhe me kushte të pranueshme për Bankën, të cilat të përfshijnë edhe mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo të drejte kompensimi, sekuestroje apo konfiskimi dhe do të autorizojë këtë bankë tregtare që t'i lejojë Bankës akses të drejtpërdrejtë në çdo kohë në të gjitha të dhënat dhe deklaratat në lidhje me llogarinë e shërbimit të huasë. Pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të mbajë në llogarinë e shërbimit të huasë një balancë minimale që përputhet me shumën e rezervës së shërbimit të huasë. Huamarrësi mund të tërheqë shuma nga llogaria e shërbimit të huasë vetëm për qëllime të kryerjes së pagesave nën marrëveshjen e huasë.

b) Huamarrësi, për qëllime të projektit, deri në përfundimin e punimeve ndërtimore të projektit, ka të drejtë të hapë dhe të mbajë një llogari të posaçme depozite (Llogaria lokale e projektit) në një bankë tregtare me terma dhe me kushte të pranueshme për Bankën, të cilat të përfshijnë edhe mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo të drejte kompensimi, sekuestroje apo konfiskimi, dhe do të autorizojë këtë bankë tregtare që t'i lejojë Bankës akses të drejtpërdrejtë në çdo kohë në të gjitha të dhënat dhe deklaratat në lidhje me llogarinë lokale të projektit. Pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi do të mbajë në llogarinë lokale të projektit një balancë minimale që përputhet me shumën e rezervës së shërbimit të huasë.

Neni 4
Dispozita financiare dhe operacionale

Seksioni 4.01 Të dhënat dhe raportet financiare

a) Huamarrësi do të mbajë, në përputhje me departamentet apo agjencitë përgjegjëse të tij për realizimin e projektit, të gjitha procedurat, të dhënat, si dhe llogaritë për të reflektuar, në përputhje me standardet e pranuara dhe të zbatuara ndërkombëtare IFRS, operacionet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me projektin, si dhe të monitorojë dhe reflektojë progresin e projektit (duke përfshirë kostot e tij, si dhe përfitimet që krijohen prej tij).

b) Huamarrësi:

i) do të ketë të dhënat dhe llogaritë në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni (duke përfshirë bilancin, deklaratën e të ardhurave dhe deklaratën e rrjedhjes së keshit dhe shënimet përkatëse), duke përfshirë ato që kanë lidhje me llogarinë e shërbimit të borxhit dhe llogarinë lokale të projektit dhe të dhënat, llogaritë dhe deklaratat financiare të pjesëve përbërëse të tij *(subsidiaries)*, për çdo vit fiskal të audituar, në përputhje me parimet dhe standardet IFRS, realizuar nga revizorë të pavarur të pranuar nga Banka, anëtarë të një organizmi kontabiliteti profesional që është pjesë e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC);

ii) do të paraqesë pranë Bankës, sapo të ketë në dispozicion, por në çfarëdo rasti jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo muaji të raportit operacional, raport, i cili do të përfshijë, *inter alia*, raportimin specifik mbi performancën *vis-à-vis* me planin e veprimit në lidhje me muajin që sapo u mbyll, të përgatitur nga ose në bashkëpunim me njësinë e kontraktuar sipas programit të asistencës menaxheriale, në detaje të mjaftueshme që i mundësojnë Bankës të përcaktojë nëse targetet tremujore që përfshihen në planin e veprimit janë arritur apo jo;

c) do të paraqesë pranë Bankës, sapo të ketë në dispozicion, por në çfarëdo rasti jo më vonë se gjashtë muaj nga mbarimi i çdo viti fiskal; (A) kopje të vërtetuara të deklaratave financiare për këtë vit fiskal të audituar (duke përfshirë deklarata financiare të veçanta për operatorin e transmetimit të

energjisë subsidar i tij, sapo kjo njësi të bëhet plotësisht operative); (B) raportin e një auditimi të tillë nga revizorët e caktuar për këtë qëllim, në detaje të tilla që t'i përgjigjen kërkesave të arsyeshme të Bankës; (C) një deklaratë të të gjitha transaksioneve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe secilit prej subsidarëve dhe afiliatëve të vet; (D) një deklaratë të raportit të mbulimit të shërbimit të borxhit të specifikuar në seksionin 4.03(a) më poshtë është mbajtur, (E) një deklaratë se raporti borxh EBITDA e specifikuar në seksionin 4.03(b) është mbajtur; (F) planin e investimeve për tre vitet pasuese; dhe (G) një raport të auditorëve që vërteton se Huamarrësi është në përmbushje të dispozitave financiare që përcaktohen në seksionin 4.03 nga fundi i vitit fiskal relevant ose, sipas rastit, duke detajuar çdo mospërmbushje; dhe

iv) do të paraqesë pranë Bankës informacione të tjera lidhur me të dhënat dhe llogaritë, sikurse dhe auditin, sa herë që kjo të kërkohet nga Banka.

Seksioni 4.02 Dispozita financiare negative

a) Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, nuk do të ndërmarrë ndonjë prej veprimeve të mëposhtme (dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme):

1. të hyjë në ndonjë marrëveshje apo kontratë për të garantuar ose në njëfarë mënyre ose nën ndonjë kusht të caktuar të detyrohet plotësisht ose pjesërisht për ndonjë detyrim financiar të një personi tjetër, duke përfshirë edhe subsidiaret ose afiliatet;

2. të hyjë në ndonjë transaksion me cilindo person, me përjashtim të rasteve në rrjedhën normale të biznesit, me terma normalë tregtarë mbi bazën e dispozitave të papërcaktuara, ose të krijojë një agjenci ekskluzivisht për blerje ose shitje, ose të hyjë në ndonjë transaksion në të cilën Huamarrësi mund të paguajë më tepër sesa çmimi normal tregtar *might pay more that* për çfarëdolloj blerje ose të përfitojë më pak sesa çmimi normal tregtar (duke përjashtuar zbritjen normale tregtare) për prodhimet dhe shërbimet e tij;

3. të hyjë në ndonjë partneritet, me ndarje fitimesh apo marrëveshje me honorare ose ndonjë marrëveshje tjetër të ngjashme, sipas së cilës të ardhurat apo fitimet e Huamarrësit duhet të ndahen me cilindo person tjetër;

4. (në mënyrë të vullnetshme ose të pavullnetshme) të bëjë ndonjë parapagim, riblerje ose shlyerje të përshpejtuar të ndonjë borxhi ose të bëjë ndonjë parapagim borxhi në përputhje me një dispozitë të një marrëveshjeje ose shënimi, i cili në mënyrë direkte ose indirekte garanton përshpejtimin e ripagimit në kohë ose në sasi, me përjashtim të rasteve të tilla, nëse Banka e kërkon këtë, Huamarrësi njëkohësisht bën një parapagim proporcional me të për principalin e mbetur të huasë ende të pashlyer në përputhje me dispozitat e seksionit 3.07 të termave dhe kushteve standarde (me kusht që çdo sasi e parapagimit të mos jetë subjekt i kërkesave për sasinë minimale të parapagimit); ose

5. të marrë përsipër ose të lejojë një shkrirje, konsolidimin ose riorganizimin, në kushtet kur Banka nuk do të vonojë ose mos pranojë në mënyrë të paarsyeshme miratimin e vet në lidhje me veprimin e kërkuar në mbështetje të deklaratës së politikave të sektorit energjetik.

b) Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur informon Bankën të paktën 30 ditë më parë, nuk do të ndërmarrë ndonjë prej veprimeve të mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin e nevojshëm që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1. të hyjë në ndonjë kontratë menaxhimi ose marrëveshje të ngjashme, sipas së cilës biznesi dhe operacionet e saj menaxhohen nga një person tjetër, duke përfshirë çdo subsidiare ose afiliate (përveç kontratave të lidhura në lidhje me programin e asistencës menaxheriale që janë të pranueshme për Bankën); ose

2. të formojë një subsidiar, ose të bëjë, ose të lejojë të ekzistojnë hua ose parapagime, ose depozitime, (me përjashtim të depozitimeve të kryera gjatë zhvillimit të biznesit normal në banka me reputacion) me persona të tjerë ose investime për një person, duke përfshirë çdo subsidiare ose afiliate; megjithatë, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi është i lirë të investojë në aksione me vlerë tregu dhe afatshkurtra me qëllimin e vetëm për të vënë në punë burimet e papërdorura të Huamarrësit.

c) Huamarrësi nuk do të hyjë pa miratimin paraprak të Bankës (ky miratim nuk mund të mos jepet në mënyrë të paarsyeshme) me një marrëveshje afatgjatë të blerjes së energjisë elektrike, e cila mund të ndikonte në vlefshmërinë kredimarrëse të Huamarrësit.

Seksioni 4.03. Dispozita të tjera financiare

Pa kufizuar përgjithësimin e seksionit 4.02, Huamarrësi, në çdo kohë:

a) do të mbajë një raport të mbulimit të shërbimit të borxhit të paktën 1.25:1;

b) do të mbajë një raport të borxhit me EBITDA jo më të lartë se 5.5:1.

Seksioni 4.04 Kryerja e operacioneve të biznesit

Huamarrësi, me përjashtim të rasteve kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të zhvillojë biznesin dhe operacionet e veta në përputhje me standardet dhe praktikat e shëndosha ndërkombëtare administrative, financiare, inxhinierike dhe të tjera, si dhe me vëmendjen e duhur ndaj çdo politike kryesore të veprimtarisë së vet;

b) do të marrë në mënyrë të menjëhershme çdo veprim brenda mundësive të veta për të mbrojtur ekzistencën e vet juridike, për të vazhduar operacionet e veta, si dhe për të përfituar, ruajtur dhe rinovuar të gjitha të drejtat, pronat, pushtetin, privilegjet dhe francaiset e nevojshme për zhvillimin e biznesit, duke përfshirë dhe kryerjen e projektit.

c) nuk do të shesë ose heqë dorë në mënyrë tjetër nga ndonjë prej aseteve të veta që janë të domosdoshme për kryerjen efiçente të operacioneve të veta ose që mund të paragjykojë mundësinë e tij për të performuar në mënyrë të kënaqshme cilindo prej detyrimeve që ka në këtë Marrëveshje;

d) do të njoftojë në mënyrë të menjëhershme Bankën për çdo propozim për të amenduar, pezulluar ose shfuqizuar ndonjë dispozitë të legjislacionit dhe do t'i ofrojë Bankës një mundësi për të komentuar mbi këto propozime përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me to;

e) do të sigurojë pranë siguruesve të përgjegjshëm ose do të ndërmarrë veprime të tjera të kënaqshme për Bankën në lidhje me sigurimin ndaj rreziqeve të dëmeve ose humbjeve, ose detyrimeve në sasi të tilla që janë në përputhje me praktikat përkatëse; dhe

f) në çdo kohë, do të operojë dhe mirëmbajë uzinat, facilitetet, pajisjet dhe çdo pronë tjetër në kushte të mira pune dhe, sapo të dalë nevoja, do të kryejë të gjitha riparimet dhe rinovimet e nevojshme në përputhje me praktikat e shëndosha financiare dhe.

Neni 5
Pezullimi, përshpejtimi

Seksioni 5.01 Ndërprerja

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 7.01.(a) (XVII) të termave dhe kushteve standarde:

a) kuadri legjislativ dhe rregullues i zbatueshëm duhet të jetë i amenduar, i pezulluar, i shfuqizuar, i anuluar apo rregulluar, me përjashtim të rasteve kur veprimet, sipas gjykimit të vetë Bankës janë në përputhje me ato të targetuara në planin e veprimit ose deklaratën e politikave të sektorit energjetik;

b) Huamarrësi do të ketë marrë të gjitha masat e referuara në seksionin 4.02(b) që mund të ndikonin materialisht dhe të mos favorizonin operacionet apo kushtet financiare të Huamarrësit, apo aftësinë e tij për të realizuar projektin apo për të përmbushur një nga detyrimet e tij të ndërmarra nën marrëveshjen e huasë;

c) kontrolli i Huamarrësit do t'i jetë transferuar një palë tjetër Garantuese; ose

d) e drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhurat e siguruara nën marrëveshjen e bashkëfinancimit do të pezullohet, anulohet apo ndërpritet, e tëra apo pjesërisht, me përputhje me termat e marrëveshjes relevante; megjithatë duhet pasur parasysh se kushtet e këtij paragrafi nuk do të gjejnë zbatim nëse Huamarrësi, me pëlqim të Bankës krijon mundësinë e vënies në dispozicion të fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit, këto nëpërmjet burimeve të tjera nga Huamarrësi, në përputhje me termat dhe kushte mbi detyrimet që ka Huamarrësi nën këtë Marrëveshje.

Seksioni 5.02 Përshpejtimi i maturitetit

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 7.06 (f) të termave dhe kushteve standarde:

a) çdo ngjarje të specifikuar në seksionin 5.01;

b) çdo ngjarje që ka ndodhur dhe vazhdon në lidhje me çdo hua tjetër të dhënë Huamarrësit nga ana e Bankës;

c) çdo ngjarje që ka ndodhur dhe vazhdon në lidhje me huanë e dhënë në zbatim të

Marrëveshjes së bashkëfinancimit,

për tridhjetë ditë pas njoftimit të dhënë nga Banka për.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01 Kushtet e kërkuara për hyrjen në fuqi

Elementet e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 9.02 (c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë për vënien në efiçencë të kësaj Marrëveshjeje.

a) Marrëveshja e bashkëfinancimit është lidhur dhe është funksionale dhe të gjitha kushtet për hyrjen e saj në fuqi apo të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqjen sipas saj janë përmbushur me përjashtim të dispozitës për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

b) Marrëveshja e garancisë është ratifikuar nga Parlamenti i Garantuesit.

c) Plani i veprimit është miratuar dhe me fuqi të plotë dhe është paraqitur materialisht në formën e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

d) Një kontratë asistence menaxheriale, që vë në jetë programin e asistencës menaxheriale, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën është lidhur.

e) PMU-ja është ngritur në një mënyrë të kënaqshme për Bankën.

f) Huamarrësi, në një mënyrë të kënaqshme për Bankën, ka përzgjedhur dhe ka caktuar një konsulent menaxhimi për projektin për të asistuar PMU-në me zbatimin e përgjithshëm të projektit deri në përfundimin e plotë të tij.

g) Huamarrësi i ka siguruar Bankës llogaritë e audituara IFRS për vitin financiar që është mbyllur në datën 31 dhjetor 2005.

h) Afatet e zbatimit të projektit dhe strategjia kontraktuese është miratuar nga Banka.

i) Deklarata e politikave të sektorit energjetik është plotësisht në fuqi dhe prodhon pasoja.

j) Fondi balancues është operacional.

k) Llogaria lokale e projektit dhe llogaria e shërbimit të borxhit janë hapur në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën dhe

l) Garantuesi ka konfirmuar afatet për zërat buxhetore dhe jobuxhetore të Huamarrësit në përputhje me planin e veprimit.

Seksioni 6.02 Opinionet ligjore

a) Për qëllime të seksionit 9.03 (a) të termave të kushteve standarde, opinioni apo opinionet ligjore do të jepen në emër të Huamarrësit nga drejtori i departamentit juridik të Huamarrësit.

b) Për qëllime të seksionit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde, opinioni apo opinionet ligjore do të jepen në emër të garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03 Përfundimi për shkak të dështimit për të hyrë në fuqi

Dita e 180-të pas nënshkruesit të kësaj Marrëveshjeje, është specifikuar për qëllime të seksionit 9.04 të termave të kushteve standarde.

Neni 7
Të ndryshme

Seksioni 7.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:
Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
Blloku “Vasil Shanto”
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendjen të: Drejtorit të Përgjithshëm
Fax (355) (4) 232 046
Për Bankën:
Banka Europiane për Rindërtimin dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2 JN, UK

Në vëmendjen të: Njësisë administrative të operacioneve
Fax: + 44-20-7338-6100

Në prani të Palëve, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kjo Marrëveshje nënshkruhet në (katër) kopje në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e shkruar në krye të Marrëveshjes.

LISTA 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është që të ndihmojë Huamarrësin e zëvendësimin e pajisjeve të vjetruara të tensionit të lartë, si dhe të sistemet e kontrollit dhe monitorimit në gjashtë nënstacione transmetimi, me synimin për të zgjatur jetëgjatësinë dhe për të përmirësuar cilësinë, qëndrueshmërinë, sigurinë dhe efiçencën e sistemit bazë të transmetimit të energjisë. Projekti do të shërbejë, gjithashtu për të lehtësuar zbatimin e projektit, fuqizuar OST-në dhe ndihmuar rajonin për të arritur një integrim më të madh me BE-në siç është parashikuar në Traktatin ECSEE që do të çonte në një treg unik të elektricitetit.

2. Projekti konsiston në zëvendësimin e pajisjeve të tensionit të lartë në gjashtë nënstacione transmetimi, si dhe instalimin e sistemeve të kontrolluara dhe monitorimit në gjashtë nënstacione transmetimi, i ndarë në pjesët e mëposhtme dhe është subjekt i modifikimeve të mëparshme, për të cilat mund të bien dakord Banka me Huamarrësin kohë pas kohe.

Pjesët e projektit	Llogaritja e kostos (në milionë euro neto pa taksat dhe tatimet)
Pjesa A: Pajisjet e tensionit të lartë dhe sistemet e kontrollit dhe monitorimit (CMS) për gjashtë nënstacione	
Pjesa A-1: Pajisje për nënstacionet: Elbasan 1, Fier, Tirana 1 dhe një sistem MS për nënstacionin e Fierit (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	22,54
Pjesa A-2: Sistem MS për nënstacionet: HAP Fierzë, Komani dhe Vau i Dejës si dhe pajisje për nënstacionin HPP Fierzë	6,98
Pjesa A-3: Pajisje dhe sistem CMS për nënstacionet: Burreli dhe Elbasan 2.	9.11
Pjesa B:	
Pjesa B-1: Operimi i PMU-së për të zbatuar pjesët A-1 deri tek A-3 më sipër, duke përfshirë mbështetjen për prokurimin, mbikëqyrjen e zbatimit, trajnimin dhe transferimin e *know-how* (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	0,8
Pjesa B-2: Fuqizimi i OST-së (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	0,8
Pjesa B-3: Studimi për çmimet e elektricitetit (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar).	0,24
Pjesa B-4: Përmirësimi i aktiviteteve të prokurimit për importin e elektricitetit (financuar prej Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar)	0,08

Shënim. Llogaria e kostos për pjesën A-1 dhe pjesën B janë konvertuar nga USD në eur duke përdorur në kurs këmbimi USD/EUR 1.23:1.

3. Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2009.

LISTA 2

KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela bashkëngjitur kësaj liste paraqet kategoritë, shumën e huasë së shpërndarë për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar në çdo kategori.

SHTOJCË E LISTËS 2

Kategoritë	Sasia e huasë së shpërndarë në monedhën e huasë	Përqindjet e shpenzimeve për t'u financuar
1. Punimet dhe shërbimet në pjesën A2	6,920,000	100% e vlerës së kontratës, subjekt i tenderimit ndërkombëtar
2. Punimet dhe shërbimet në pjesën A3	8,920,000	100% e vlerës së kontratës, subjekt i tenderimit ndërkombëtar
3. Komisioni përmbyllës	160,000	100% e komisionit përmbyllës
Totali	16,000,000	